



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 81, datë 29.04.2025

PËR

***“CAKTIMIN E PÛRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM Durrës”***

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
6. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 29.04.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës
së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”***

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 1253 prot., datë 28.04.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin zotin Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është emëruar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Posaçme (SPAK).
3. Me qëllim plotësimin e vakancës së krijuar, Këshilli caktoi përkohësisht prokuroren Suela Beluli në pozicionin e drejtuesit të kësaj zyre prokurorie me vendimin nr. 189 datë 31.07.2024, nr. 229, datë 29.10.2024, si dhe me vendimin nr. 18, datë 30.01.2025, për periudhën 03.02.2025 deri më 02.05.2025.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 236, datë 13.11.2024, ka shpallur vendin vakant, për drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.
5. Në përfundim të afatit kanë shprehur interesin dy prokurorë për të cilët procedura administrative parashikon verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore.
6. Në këto kushte, Këshilli vlerëson të vijojë procedurën për plotësimin e kësaj vakance nëpërmjet caktimit të përkohshëm të një prokurori. Kjo procedurë, bazohet parashikimet e nenit 42 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili në pikën 1, parashikon se:
 - “Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:
 - a. caktimit në pozicione të tjera;
 - b. arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji;”
 - Ndërsa, neni 42 pika 2, i ligjit të sipërpërmendur përcakton se:

“ 2... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”



- Ndërkohë, neni 3 i Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, përcakton se:

“1.Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.

2.Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.”

7. Në aplikim të sa më sipër, Këshilli me vendimin 18, datë 30.01.2025, ka vendosur të caktojë përkohësisht zonjën Suela Beluli, në pozicionin e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në tre muaj duke filluar nga data 03.02.2025.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, vlerëson se:

8. Plotësimi i pozicionit vakant të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është proces që garanton organizimin e punës, mirëfunksionimin e prokurorisë, përfaqësimin e prokurorisë në marrëdhënie me të tretët etj. Këshilli vlerëson se zonja Suela Beluli përmbush kriteret ligjore për të ushtruar këtë funksion si i caktuar përkohësisht. Prokurorja Suela Beluli ka mbi 9 (nëntë) vite vjetërsi si magjistrat dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Gjatë kësaj periudhe, prokurorja Suela Beluli do të përfitojë pagën e drejtuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenet 42 dhe 59, pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zonja Suela Beluli, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Zonja Suela Beluli do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë tre mujore, duke filluar nga data 03.05.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Suela Beluli, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 29.04.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Olger Eminaj